



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:240798

Datë: 12.08.2024

Numri i dokumentit: 06038868

C.nr.994/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.Q, nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson Av. D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 546.00 euro, jashtë seancës, më datën 12.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.Q, nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit.

DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.Q, nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 273 ditë pune të ja paguajë shumën prej 546.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 03.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit M.Q, t'i paguajë shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja M.Q, nëpërmjet përfaqësuesi të tij të autorizuar më datën 03.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 546.00 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se ka punuar dhe vazhdon të punojë si mësimdhënëse në SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zaqishtë, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditësit i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 22.01.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas

padisë është nga data 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 dhe atë për 273 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 05.08.2024, ku ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë më 01.03.2024, me të cilën kanë kërkuar kompensimin në emër të ushqimit për periudhën kohore 18.04.2021 – 21.11.2022. Paditësi nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Paditësi me aktgjykim të kësaj gjykate C.nr.791/2021, me nr. të lëndës 2021:174780, të datës 24.11.2023, është kompensuar në emër të shpenzimeve të ushqimit në punë, për periudhën kohore 01.01.2021 - 17.04.2021. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1354/2 i datës 12.07.2023, i lëshuar nga SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zaqishtë, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 395/2, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit M.Q.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësja për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1354/2 i datës 12.07.2023, i lëshuar nga SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zaqishtë, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi M.Q në periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 273 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 395/2, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditësit M.Q dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Reti e Poshtme, Komuna e Rahovecit.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi në periudhën kohore nga data 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tij të punës ka prezantuar në 273 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimi i lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 133 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 266 euro.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 03.11.2023, ndërsa kërkesëpadija e paditësve është për periudhën nga data 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se paditësi M.Q, me aktgjykim të kësaj gjykate C.nr.791/2021, me nr. të lëndës 2021:174780, të datës 24.11.2023, është kompensuar në emër të shpenzimeve të ushqimit në punë, për periudhën kohore 01.01.2021 -17.04.2021, gjykata nuk e morri për bazë ngase kërkesëpadija përfshin periudhën 18.04.2021, e deri me datën 21.11.2022, për këtë periudhë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t'ia kompensojë të paditësit shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.994/2023, më datën 12.08.2024

Bashkëpunëtori profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.